

Programi IPA 2010 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë

***Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të
Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin e Ligjit
dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar të Mjedisit***
(EuropeAid/130987/C/SER/AL)

**Udhëzues për
Lejet e Mjedisit
Aktiviteti C.3**

Dokumenti Përfundimtar



Projekti është financuar
nga Bashkimi Evropian

Titulli i Projektit:	Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin e Ligjit dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar të Mjedisit	
Numri i Projektit:	Europe Aid/130987/C/SER/AL;	
No. Kontratës.	2011/275-693	
Vendi:	Republika e Shqipërisë	
	Përfitues	Kontraktor
Emri:	Ministria e Mjedisit	Grontmij A/S
Adresa:	Rr. Durrësit, Nr 27, Tiranë, Shqipëri	Granskoven 8 DK-2600 Glostrup
Person i kontaktit:	Ardiana Sokoli	Paolo Bacca
Telefon:	+355 4 2270622	+355 4 2226493
E-mail:	Ardiana.Sokoli@moe.gov.al	Paolo.Bacca@selea.al
Data e Raportit:	Qershor 2014	
Titulli:	Udhëzues për Lejet e Mjedisit	
Autorët:	Kurt Terpgaard-Jensen & Erjola Muka	
QA/QC	Paolo Bacca	

Mirënjohje

Ekipi i projektit dëshiron të shprehë mirënjohjen e TIJ për të gjithë personat dhe ekspertët nga të gjitha institucionet dhe palët e interesuara të përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe informatave dhe të gjithë personat dhe organet që kanë mbështetur zhvillimin e këtij materiali. Falënderime të veçanta shkojnë për drejtuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Ky raport është përgatitur nga një ekip projekti që punon për Grontmij. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të Grontmij dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të merren për të pasqyruar mendimet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Tabela e Përmbajtjes

1	HYRJE	3
1.1.	QËLLIMI I UDHËZUESIT	3
1.2.	LEJET E MJEDISIT DHE VNM	3
1.3.	KËRKESA PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A, B APO C?	4
2	TEORIA DHE KUADRI	5
2.1.	FUSHËVEPRIMI I LEJEVE TË MJEDISIT	5
2.2.	SISTEMI I LEJEVE	5
2.3.	ASPEKTET INSTITUCIONALE TË LEJEVE TË MJEDISIT	5
3	PROCEDURA E DHËNIES SË LEJES SË MJEDISIT	7
3.1.	KËRKESA PËR LEJE MJEDISI NGA OPERATORI	7
3.2.	PRANIMI DHE KONTROLLI FILLESTAR I FORMULARIT TË KËRKESËS	7
3.3.	KONSULTIMI	7
3.4.	VLERËSIMI TEKNIK I FORMULARIT TË KËRKESËS	7
3.5.	DHËNIA E LEJES OSE NJOFTIMI I REFUZIMIT TË LEJES	8
3.6.	RISHIKIMI APO PEZULLIMI I LEJES SË MJEDISIT	8
3.7.	REVOKIM APO PEZULLIMI I LEJES SË MJEDISIT	8
4	VENDOSJA E KUSHTEVE NË LEJET E MJEDISIT	10
4.1.	LEJE E MJEDISIT E TIPIT A	10
4.2.	LEJE E MJEDISIT E TIPIT B	11
4.3.	LEJE E MJEDISIT E TIPIT C	11
4.4.	PERIUDHA KALIMTARE	11
4.5.	RISHIKIMI I LEJEVE	12
	ANEKSIA - PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR NJË LEJE MJEDISI	13
	TIPI A DHE B –FORMULARI I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISI	13
	TIPI C –KËRKESA PËR LEJE MJEDISI	13
	ANEKSI B - PËRMBAJTJA TEKNIKE E NJË LEJE MJEDISI	15
	ANEKSI C - VENDOSJA E VLERAVE KUFIT TË SHKARKIMIT	16

Lista e Shkurtimeve

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQV	Autoritetet e Qeverisjes Vendore
ARM	Agjencitë Rajonale të Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
BREF	Best Environmental Reference Note Dokumenta Reference të TMD
DDP	Dispozita Detyruese të Përgjithshme
IKM	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit
IPPC	Integrated Pollution Prevention and Control Direktiva e Kontrollit dhe Parandalimit të Integruar të Ndotjes
LLM	Ligji mbi Lejet e Mjedisit
MM	Ministria e Mjedisit
PPP	Plani i Programit të Përputhshmërisë
QKL	Qendra Kombëtare e Licencave
SCM	Standardet e Cilësisë Mjedisore
TMD	Teknikat më të Mira në Dispozicion
VKSh	Vlerat Kufi të Shkarkimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1 HYRJE

1.1. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i Udhëzuesit për Lejet e Mjedisit për Shqipërinë është që të sigurojë një dokument të shkurtër për një audiencë më të gjerë, stafin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM-të), si një mjet që do ta bëjë më të lehtë të kuptuarin e Procesit të Lejeve të Mjedisit.

Udhëzuesi i VNM-së, gjithashtu shkurtimisht sqaron dallimin midis Lejeve të Mjedisit dhe Procesit të VNM-së, si pjesë e Miratimit/Lejes për Zhvillim.

Leja e Mjedisit është një instrument ligjor për reduktimin, minimizimin apo shmangien e ndikimeve në mjedis nga funksionimi i instalimeve ndotëse, sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat mjedisore dhe promovimin e teknikave miqësore ndaj tij. Gjithashtu, leja e mjedisit i kushton vëmendje rehabilitimit apo kujdesit, pas përfundimit të një aktiviteti.

Deklarata Mjedisore është një instrument ligjor për të vlerësuar një projekt të ri zhvillimi, për të minimizuar apo shmangur ndikimet në mjedis. VNM-ja është pjesë e një procesi vlerësimi të përgjithshëm për të rezultuar më pas në një Pwlqim Zhvillimi (vlerësimi i ndikimit në mjedis, vlerësimi i planifikimit hapësinor, leja e ndërtimit, etj).

Udhëzuesi përshkruan elementet kyç të sistemit të lejeve të mjedisit, duke përfshirë:

- **Parimet themelore** të lejeve të mjedisit (për AKM-në dhe ARM-të)
- **Procedurat, në vija të përgjithshme**, të dhënies së lejeve (për AKM-në dhe ARM-të)
- Udhëzim të shkurtër mbi **procesin e lejeve të Tipit A dhe B (për AKM-në)**
- Udhëzim të shkurtër mbi **procesin e lejeve të Tipit C (për ARM-të)**

Ky Udhëzues plotësohet nga Udhëzuesi për Kërkuesin e Lejes - si të përgatisësh një Leje Mjedisit. Nëse do të jetë i nevojshëm më shumë informacion, do të gjendet një i tillë në Manualin e Lejeve të Mjedisit, i cili përmban maksimumin e informacionit, listat e kontrollit, etj.

Ashtu si për procesin e Lejeve të Mjedisit, edhe për procesin e VNM-se janë përgatitur një Udhëzues dhe Manual.

1.2. LEJET E MJEDISIT DHE VNM

VNM-ja është një proces vetëm për projektet E REJA të zhvillimit (duke përfshirë instalimet ndotëse, por kryesisht për projektet e infrastrukturës). Lejet e Mjedisit lëshohen për instalime TË VJETRA DHE TË REJA, ndotëse.

Rezultati i procesit të VNM-së është Deklarata Mjedisore - rezultati i procesit të Lejeve është Leja e Mjedisit.

Leja e Mjedisit përgatitet nga AKM-ja, firmoset nga Ministri dhe lëshohet nga QKL-ja. Lejet e Mjedisit kontrollohen nga Inspektorati i Mjedisit, për përputhshmëri me kushtet e funksionimit dhe rehabilitimit të instalimit.


Deklarata Mjedisore përgatitet nga AKM-ja dhe firmoset nga Ministri. Është autoriteti i planifikimit që lëshon Pëlqimin për Zhvillimin. Kushtet mjedisore që lidhen me ndërtimin e projektit të zhvillimit (si pjesë e Deklaratës Mjedisore) kontrollohen nga Inspektorati i Mjedisit për përputhshmëri.

Procesi i VNM-së ndërmerret përpara trajtimit të mundshëm të Lejes së Mjedisit.

Nëse një zhvillues do të ngrejë një instalim të ri ndotës (Tipi A ose B), si Deklarata Mjedisore ashtu edhe Leja e Mjedisit, mund të jetë e nevojshme.

Procesi i VNM-së kryhet kryesisht për të justifikuar vendndodhjen më të mirë, nga pikëpamja mjedisore, të një projekti të ri infrastrukturor ose një instalimi të ri, ndotës.

Dallimet dhe ngjashmëritë midis procesit të VNM-së dhe procesit të Lejes së Mjedisit janë ilustruar në figurën më poshtë:



Listat përkatëse, të projekteve të zhvillimit dhe aktiviteteve, janë anekse të kuadrit ligjor mbi VNM-në dhe Lejet e Mjedisit. Përpunimi i një kërkesë për VNM ose Leje Mjedisit varet nëse instalimi është i renditur në njërin apo tek të dy këto lista.

1.3. KËRKESA PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A, B APO C?

Kur aplikoni për Leje Mjedisit është e rëndësishme të sqarohet se kush është Tipi i lejes (tipi A, B ose C?) që duhet të trajtohet.

Legjislacioni për Lejet e Mjedisit, në mënyrë të qartë, bën dallimin midis tre tipeve të lejeve të mjedisit:

- Tipi A - për instalime ndotëse të renditura në kolonën e titulluar "Pragu i Kapaciteteve të Tipit A" në Aneksin I të ligjit Nr. 10048, datë 14.07.2011 për "Lejet e mjedisit".
- Tipi B - për instalime ndotëse të renditura në kolonën e titulluar "Pragu i Kapaciteteve të Tipit B" në Aneksin I të Ligjit Nr. 10048, datë 14.07.2011 për "Lejet e mjedisit".
- Tipi C-për instalime të renditura në kolonën e titulluar " Pragu i Kapaciteteve të Tipit C" në Aneksin I të Ligjit Nr. 10048, datë 14.07.2011 për "Lejet e mjedisit".

Kërkuesi duhet të përdorë formularin e duhur të kërkesës që korrespondon me llojin e lejes së mjedisit për të cilën aplikon (Tipi A, B ose C).

2 TEORIA DHE KUADRI

2.1. FUSHËVEPRIMI I LEJEVE TË MJEDISIT

Lejet e Mjedisit janë hartuar si leje të integruara.

Lejet e Mjedisit përcaktojnë kushtet (standardet janë të renditura në Aneksin B), si psh:

- Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër dhe ujë
- Menaxhimi i mbetjeve
- Shkarkimet e zhurmës
- Përdorimi efikas i lëndëve të para
- Monitorimi

Përveç kësaj, Lejet e Mjedisit merren me teknikën e aplikuar për të minimizuar shkarkimet, mënyrën si instalimi menaxhohet në situata normale, se si është planifikuar komunikimi në rast të aksidenteve, komunikimi me institucionet dhe publikun dhe si duhet të ndërpriten/pushohen operacionet, se si duhet bërë nxjerrja nga përdorimi dhe rehabilitimi i vendit të instalimit.

Detajet e këtyre dispozitave varen nga lloji i instalimit. Disa kushte mjedisore janë standardizuar, ndërsa disa janë të projektuara rast pas rasti, për një instalim të veçantë.

2.2. SISTEMI I LEJEVE

Sistemi i lejeve, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit është përcaktuar me ligjin Nr. 10488, datë 14.07.2011 mbi Lejet e Mjedisit, i cili siguron parimet themelore për të gjitha tipet e lejeve të mjedisit.

Tiparet kryesore të Ligjit janë si më poshtë:

- Është themeluar një sistemi i tre tipeve të lejeve të mjedisit- **Tipi A, B dhe C**- të tre tipet e lejeve dallohen nga njëra-tjetra nga kategoria e aktivitetit industrial dhe kapacitetit të prodhimit
- Kërkesat për leje pranohen dhe lëshohen nga QKL
- **AKM / ARM përgatit propozimet për lejet e mjedisit**
- Lejet për instalimet industriale jepen **duke marrë parasysh kushtet lokale.**
- **Pjesëmarrja e publikut dhe aksesit në informacion** (publiku duhet të ketë një mundësi për të komentuar mbi kërkesat për leje para se autoriteti përkatës arrin vendimin e vet dhe të kenë akses në informacionin e lidhur me lejet, pasi leja është dhënë)
- Përdorimi i **Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) për Tipin A** (konsumi i burimeve (ujit dhe materiale të tjera të papërpunuara) dhe përdorimi efikas i energjisë)
- Fokusi mbi **parandalimin dhe reduktimin e ndotjes** në vend të kontrollit në momentin e shkarkimit.
- Kthimi i vendit të instalimit në një gjendje të kënaqshme, pasi instalimi është e mbyllur.

2.3. ASPEKTET INSTITUCIONALE TË LEJEVE TË MJEDISIT

Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) është autoriteti "One-stop-shop" për marrjen e të gjithë formularëve të kërkesës. QKL-ja është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku leja e mjedisit e tipit A, B dhe C lëshohet. QKL-ja shpërndan kërkesën për leje tek organi përkatës kompetent.

Kërkesa përpunohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (**AKM**) (Tipi A dhe B) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (**ARM**), (tipi C). Autoriteti i mjedisit kontrollon që të gjitha informatat teknike të jenë paraqitur.

Lejet e Tipit A dhe B janë të administruara nga AKM-ja, e cila i ofron mendimin teknik **Ministrit** për dhënien ose jo të lejes së mjedisit (me kushte të hollësishme). QKL lëshon lejen e mjedisit.

Lejet e Tipit C janë përgatitur nga ARM-të përkatëse dhe lëshohen nga QKL-ja.

3 PROCEDURA E DHËNIES SË LEJES SË MJEDISIT

Lëshimi i lejes së mjedisit përfshin, përgjithësisht fazat e mëposhtme:

1. Përgatitja/plotësimi i formularit të kërkesës nga **Operatori**;
2. Kontrolli paraprak i përputhshmërisë administrative të kërkesës, bërë nga **QKL**;
3. Kontrolli paraprak teknik, nga **AKM / ARM**;
4. Konsultimi me autoritetet përkatëse dhe publike, nga **AKM / ARM**;
5. Vlerësimi teknik i kërkesës, nga **AKM / ARM**;
6. Vendosja e kushteve të lejes së mjedisit, nga **AKM / ARM**;
7. **AKM** përgatit propozimin për Ministrin (Tipi A dhe B);
8. **Ministri** firmos për dhënie apo refuzimin e lejes së mjedisit (tipi A dhe B);
9. **QKL-ja** përcjell/lëshon lejen e mjedisit apo aktin e refuzimit të lejes së mjedisit, dhe;
10. Procedura e Apelimit/ Ankimimit

3.1. KËRKESA PËR LEJE MJEDISI NGA OPERATORI

Formularët e kërkesës janë përgatitur /plotësuar nga operatori i instalimit. Operatori është përgjegjës për të bërë kërkesën për leje mjedisi. Në dispozicion është një formular standard kërkesë, i cili pritët të jetë i detyrueshëm me ligj, për të siguruar një informacion të plotë teknik, prej tij.

Ekzistojnë tri lloje të formave të kërkesës për leje mjedisi:

1. Formular Kërkesë për Lejen e Mjedisit të Tipit A;
2. Formular Kërkesë për Lejen e Mjedisit të Tipit B; dhe
3. Formular Kërkesë për Lejen e Mjedisit të Tipit C.

3.2. PRANIMI DHE KONTROLLI FILLESTAR I FORMULARIT TË KËRKESËS

Kjo procedurë përcakton një proces me dy hapa për të përcaktuar vlefshmërinë e aplikimit:

1. *Kontrolli paraprak administrativ nga QKL-ja*
Konfirmimi se kërkesa është e vlefshme nga ana administrative, bërë nga **QKL-ja**
2. *Kontrolli paraprak teknik nga AKM/ARM*
Konfirmimi se kërkesa është e vlefshme nga ana teknike, bërë nga **AKM / ARM**, apo Kërkohen më shumë informacione teknike

3.3. KONSULTIMI

Kur kërkesa për leje mjedisi është konsideruar (administrativisht dhe teknikisht) e vlefshme, AKM-ja/ARM-ja duhet të:

- Konsultohet me institucione të tjera;
- Konsiderojnë nëse dhënia e lejes së mjedisit mund të jetë në konflikt me kërkesat e autoriteteve të tjera;
- Marr në konsideratë pikëpamjet e publikut.

3.4. VLERËSIMI TEKNIK I FORMULARIT TË KËRKESËS

Vlerësimi teknik kërkesës bëhet nga AKM/ARM, e cila:

- Vlerëson në detaje informacion teknik, të dhënë;
- Vlerëson ndikimin në mjedis;
- Vlerëson efektet kumulative të mundshme, nga instalime të tjera;
- Konsideron masat e nevojshme zbutëse;
- Konsideron efektin e integruar nga një mjedis në një tjetër (pastrimi i ajrit me ujë mund të rezultojë në ujëra të zeza të rrezikshme);
- Vlerëson TMD-të e mundshme (Tipi A);
- Konsideron kushtet e nevojshme për funksionimin e instalimit;
- Konsideron VKSh-të për shkarkimet në fjalë
- Konsideron investimet mjedisore, të nevojshme për instalimin ekzistues për të qenë në përputhje me kërkesat mjedisore të TMD-ve, me kalimin e kohës (Tipi A)

Pas vlerësimit mjedisor dhe teknik të kërkesës, AKM-ja duhet të vendosë nëse do të propozojë për dhënie të lejes së mjedisit apo për refuzimin e lejes.

3.5. DHËNIA E LEJES OSE NJOFTIMI I REFUZIMIT TË LEJES

Ministri firmos aprovimin apo njoftimin për refuzimin e lejes së mjedisit të Tipit A dhe B, sipas propozimit të AKM-së.

ARM-ja përkatëse miraton apo njofton refuzimin e lejes së mjedisit të Tipit C.

AKM/ARM dorëzon në QKL, dokumentet e lejes së mjedisit apo njoftimin e refuzimit të saj. Lëshimi përfundimtar i lejes së mjedisit apo njoftimit të refuzimit bëhet nga QKL-ja.

QKL-ja publikon lejen e mjedisit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, e cila është në dispozicion për publikun.

3.6. RISHIKIMI APO PEZULLIMI I LEJES SË MJEDISIT

Një leje mund të rishikohet ose të pezullohet, në rast se:

- funksionimi i një instalimi në Shqipëri ka të ngjarë të ketë efekte të rëndësishme negative në mjedisin e një shteti tjetër;
- me ligj, rishikimi gjykohet i nevojshme;
- me kërkesë të operatorit, janë parashikuar ndryshime për procesin e rregullimit ose nëse ka ndryshime në pronësinë e operatorit ose të dhënave të kontaktit; dhe
- autoriteti përkatës gjeni se objektivat dhe/ose standardet e cilësisë së mjedisit, të zbatuar, janë modifikuar.

Operatori mund të ndërpres vullnetarisht lejen e mjedisit, në qoftë se kjo bëhet për arsye tregtare apo arsye të tjera personale, por ka të bëjë në mënyrë përmes një aplikim formal të autoritetit përkatës.

3.7. REVOKIM APO PEZULLIMI I LEJES SË MJEDISIT

Një leje mund të revokohet kur operatori i instalimit ka dështuar të paguajë tarifën përkatëse, në respekt të kërkesave të ligjit. Ministri/AKM-ja duhet t'i bëjë një kërkesë formale QKL-së për revokimin e lejes së mjedisit.

Me kërkesë të AKM-së, Ministri mund të pezullojë apo revokojë, përkohësisht, një leje mjedisi, kur:

- a) Një kërkesë për një veprim të tillë është dorëzuar nga operatorit;

- b) Kushtet e përcaktuara në lejen e mjedisit nuk janë përmbushur;
- c) Operatori është i dënuar, për një vepër penale;
- d) Operatori ka shkelur shumë herë legjislacionin mjedisor;

Revokimi apo pezullimi i përkohshëm i lejes së mjedisit ndërmerret vetëm kur ka dështuar përdorimi i të gjitha mjeteve detyruese, për të mbrojtur mjedisin.

Inspektorët e mjedisit, gjithashtu, kanë kompetenca që të pezullojnë ose revokojnë një leje mjedisi, në tërësi ose pjesërisht, duke paraqitur një njoftim zyrtar tek operatori.

4 VENDOSJA E KUSHTEVE NË LEJET E MJEDISIT

Asnjë person nuk duhet të operoj një instalim, pa patur më parë një leje mjedisit.

Leja e mjedisit duhet të përmbajë kushte, të cilat janë:

- Të Thjeshta (**S**imple)
- Të Matshme (**M**easurable)
- Të Sakta (**A**ccurate)
- Realiste (**R**ealistic)
- Me Afat kohor (**T**imebound)

Parimi **SMART** është i rëndësishme për të siguruar që kushtet e vendosura në lejen e mjedisit, janë të zbatueshme.

Çelësi për një leje të thjeshtë, efikase dhe konsekuente është që kushtet e saj të bazohen në standardet dhe në udhëzuesin teknik, për të cilin është rënë dakord nga të gjitha palët, e që janë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe publikun.

4.1. LEJE E MJEDISIT E TIPIT A

Leja e Mjedisit, e Tipit A, duhet të marr parasysh performancën mjedisore të instalimit apo aktivitetit, si një i tërë dhe përfshin kontrollin e të gjitha shkarkimeve në të gjitha mjediset.

Për sa më sipër, kushtet e lejes duhet të përfshijnë:

- **Përshkrimin e instalimit** dhe aktivitetet të tij, vendin, topografinë, dhe rrethinat;
- **Përdorimin e lëndëve të para** dhe kimikateve, ujin dhe konsumin e energjisë;
- Burimin e **shkarkimeve** në ajër, ujë apo tokë;
- Prodhimin e **mbetjeve** dhe nevojën për minimizimin e mbetjeve, përmes riciklimit;
- **Efektin e zhurmës dhe dridhjeve**;
- Teknologjinë e propozuar dhe teknikat e tjera (**TMD**) për të parandaluar ose reduktuar shkarkimet;
- **Vetë-monitorimin** (monitorimin e efikasitetit të pajisjeve të përpunimit/trajtimit, pajisjet dhe shkarkimet);
- Masat që duhet të ndërmerren kur **pushon aktiviteti**, duke përfshirë edhe veprimet korrigjuese/rehabilituese.

Leja e Mjedisit duhet të përcaktojë për ndotësit, vlerat kufi të shkarkimeve, sipas TMD-ve. Çdo vlerë kufi e shkarkimit dhe çdo dispozitë tjetër duhet të jetë në vlera minimale.

Leja e Mjedisit duhet të përfshijë edhe dispozitat mbi:

- Detyrimin e operatorit apo personit të ngarkuar, që menjëherë të raportoj situata të shkeljes së kushteve të lejes (jo-pajtueshmërisë)
- Ndërmarrjen e menjëhershme të veprimeve për të minimizuar ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedis, në rast të një aksidenti apo incidenti,

Një Format Standard Leje është i zhvilluar, me synim lehtësimin e punës së stafit që përgatit kushtet e lejes së mjedisit.

4.2. LEJE E MJEDISIT E TIPIT B

Leja e Mjedisit, e Tipit B është disi e ngjashme për Lejen e Mjedisit, të Tipit A, përveç faktit se kjo leje nuk është e bazuar në TMD-të. Leja e Mjedisit të Tipit B duhet të sigurojë përputhshmërinë me të gjitha standardet minimale teknike dhe me çdo standard të cilësisë mjedisore.

4.3. LEJE E MJEDISIT E TIPIT C

Leja e Mjedisit, e Tipit C është një leje e thjeshtë, me kushte të kufizuara, nëse ka ndonjë të tillë.

4.4. PERIUDHA KALIMTARE

Është e ditur se për instalimet ekzistuese të Tipit A (që do të thotë ato instalime që kanë qenë në operim, në datën kur Ligji për Lejet e Mjedisit ka hyrë në fuqi) mund të jetë e nevojshme një periudhë kalimtare, para se këto instalime të mund të jenë plotësisht në përputhshmëri me të gjitha kërkesat mjedisore.

Për këtë arsye, është zhvilluar -plani i veprimit të përputhshmërisë(PVP) - një mjet i veçantë menaxhimi. PVP përshkruan veprimet e nevojshme që duhen ndërmarr me kalimin e kohës, për të qenë plotësisht në përputhje me të gjitha kushtet. PVP mundëson operatorin të planifikoj, ndryshimet e nevojshme dhe për të siguruar më tej fondet e nevojshme, për zbatimin e tyre.

Instalimet ekzistuese të Tipit A dhe B duhet të jenë në përputhje me Ligjin e ri për Lejet e Mjedisit, jo më vonë se 8 vjet pasi ligji hyri në fuqi (qershor 2019). Gjithashtu, edhe instalimet e Tipit C duhet të jenë në përputhje me Ligjin për Lejet e Mjedisit. Për aktivitetet industriale të Tipit C nuk është i nevojshëm asnjë Plan Kohor i Përputhshmërisë.

Forma: Plani Kohor i Përputhshmërisë dhe Afati

PLANI KOHOR I PËRPUTHSHMËRISË						
Tabela 1. Aktivitetet për përputhshmërinë me tipin e lejes së mjedisit ose të tipit B lejen mjedisore						
Nr.	Aktivitetet	Investimet (EUR)	Fillimi i veprimtarisë (data)	Fundi i veprimtarisë (data)	Rezultatet e Aktivitetit	Metoda e kontrollit

Aktivitetet:Përshkrimi i aktivitetit/aktiviteteve të cilat do të ndërmerren, nga instalimet në mënyrë që të arrihet përputhshmëria me legjislacionin mjedisor.

Investimet:Investimet për këtë aktivitet (financiar do të thotë treguesi i nevojshëm për realizimin e secilës fazë të planit operacional dhe treguesin e pajisjeve të përgjithshme, të nevojshme për arritjen e planit.

Fillimi:Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar fillimi i aktivitetit.

Përfundimi:Data (muaji / viti) në të cilin është planifikuar përfundimi i aktivitetit ose futja në operim.

Rezultatet e Aktivitetit:rezultati specifik duhet të përshkruhet (p.sh.: reduktimi i shkarkimit)

Metoda e kontrollit:Përshkrim i mënyrës , se si aktiviteti i kryer mund të kontrollohet

Tabela 2. Afatet kohore për zbatimin e aktiviteteve në tabelën 1 dhe investimet vjetore						
Nr.	Aktivitetet	Shpenzimet sipas viteve – EURO				
		Viti	Viti	Viti	Viti	Viti

Viti: Analiza kosto-përfitim nga operatori duke siguruar shpenzimet e nevojshme vjetore për zbatimin e secilit nga aktivitetet e Tabelës 2.

4.5. RISHIKIMI I LEJEVE

Kushtet e Lejes së Mjedisit duhet të rishikohen periodikisht nga AKM/ARM. Qëllimi i rishikimit është që të vlerësojnë nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e lejes. Procesi i rishikimit mund të kërkojë edhe kryerjen e një vizite në aktivitetin industrial ose kërkoj informacion nga inspektorët.

Të gjitha ndryshimet duhet t'i bëhen të ditura, zyrtarisht, operatorit.

ANEKSIA - PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR NJË LEJE MJEDISI

Duhet të zbatohen, detyrimisht, formularët standard të kërkesës.

Ekzistojnë tri lloje të formularëve standard, të detyrueshëm me ligj, për t'u shfrytëzuar nga kërkuesi i lejes:

- Formulari i Kërkesës për Leje Mjedisit të Tipit A
- Formulari i Kërkesës për Leje Mjedisit të Tipit B
- Formulari i Kërkesës për Leje Mjedisit të Tipit C

Informacionet e kërkuara në Formularin e Kërkesës për lejet e Tipit A dhe B janë shumë të ngjashme dhe mes të tjerash përfshijnë, si më poshtë vijojnë:

Tipi A dhe B –Formulari i Kërkesës për Leje Mjedisit

1. Identiteti i instalimit.
2. Identiteti i Operatorit, detajet e kontaktit dhe statusi ligjor i operatorit në mënyrë që të dihet qartësisht se kush është përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë me lejen dhe kush është përgjegjës në rastin e veprimeve detyruese, për çdo mos-përputhshmëri.
3. Qëllimi i instalimit. Është i nevojshëm të jepet një përshkrim i qartë për të gjitha aktivitetet dhe objektet përkatëse që përbëjnë instalimin, për të cilat kërkohet leja e mjedisit.
4. Teknikat operacionale dhe ato të menaxhimit. Kërkesa duhet të demonstrojë se teknikat që do të përdoren në instalim, për të minimizuar krijimin e mbetjeve dhe për të parandaluar shkarkimet, janë në përputhje me TMD-të. Teknikat që mund të adresohen, përfshijnë si në vijim:
 - Përdorimi i lëndëve të para dhe ujit;
 - Parandalimi dhe kontrolli i shkarkimeve dhe mbetjeve;
 - Menaxhimi i mbetjeve;
 - Përdorimi i energjisë dhe efikasiteti i përdorimit;
 - Plani i emergjencës;
 - Sistemet e monitorimit;
 - Çmontimi dhe rehabilitimi; dhe
 - Sistemi i Menaxhimit Mjedisor
5. Shkarkimet e Propozuara. Duhet të sigurohen detaje për të gjitha shkarkimet që rezultojnë nga operimi i impiantit dhe duhet të demonstrohet përputhshmëri me sektorët përkatës të bazuar në TMD, në të cilën do të bazohen VKSh.
6. Ndikimi i Shkarkimeve në Mjedis. Duhet të jepet informacion mbi rezultatet e vlerësimit të çfarëdolloj ndikimi domethënës në mjedis si pasojë e shkarkimeve të mësipërme. Qëllimi i këtij vlerësimi është që të demonstrojë se ndikimet do të jenë të pranueshme, përmes përputhshmërisë me standardet e cilësisë mjedisore. Pamundësia për të demonstruar këtë përputhshmëri, mund të çojë në refuzimin e kërkesës. Për më tepër, ku një instalim kërkon Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kërkesa duhet të përfshijë gjithashtu çdo informacion të përftuar ose përfundimet e arritura në lidhje me instalimin, nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.
7. Përmbledhja jo-teknike shkruar nga kërkuesi, e cila mund të përdoret në regjistrin publik. Materiali duhet të ndjekë strukturën e kërkesës dhe të jetë i detajuar, dhe në gjuhë të atillë që të lejojë publikun të kuptojë propozimin, e si rrjedhojë të ketë një përgjigje të ndjeshme prej tij.

Tipi C –Kërkesa për Leje Mjedisit

- Emri dhe adresa e operatorit.

- Vendndodhja e aktivitetit.
- Përshkrimi i aktivitetit.
- Natyra dhe sasia e çdo çlirimi ndotës (shkarkimi i ujërave të zeza <20m3 trajtim ujërash të zeza/ditë) (shkarkimet në ajër - asnjë ndotës toksik në ajër <100 ton në vit, jo-toksike).
- Gjenerimi i mbetjeve(asnjë mbetje të rrezikshme <534 ton mbetje në vit).
- Shkalla maksimale, në të cilën është përdorur energjia.
- Deklarata për ndonjë kundërmim
- Deklarata për çdo nivel të zhurmës
- Ruajtje e sigurt e materialeve të rrezikshme

ANEKSI B - PËRMBAJTJA TEKNIKE E NJË LEJE MJEDISI

Një Leje e Integruar e Mjedisit duhet të përmbaj, të paktën, kushtet teknike të mëposhtme:

- | | |
|------------------|--|
| Kushti 1 | Fushëveprimi |
| Kushti 2 | Menaxhimi i Instalimit |
| Kushti 3 | Operimi dhe Infrastruktura |
| Kushti 4 | Programi i Përputhshmërisë |
| Kushti 5 | Interpretimi |
| Kushti 6 | Njoftimet |
| Kushti 7 | Shkarkimet |
| Kushti 8 | Menaxhimi i mbetjeve |
| Kushti 9 | Zhurma |
| Kushti 10 | Lëndët e para dhe shfrytëzimi i energjisë |
| Kushti 11 | Monitorimi |
| Kushti 12 | Dokumentimi dhe raportimi tek autoriteti kompetent |
| Kushti 13 | Incidentet dhe reagimet gjatë emergjencave |
| Kushti 14 | Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së opererimit |

ANEKSI C - VENDOSJA E VLERAVE KUFIT TË SHKARKIMIT

Vendosja e VKSh-ve në lejet e integruara duhet të bazohet në qasjen ndaj standardeve të cilësisë së mjedisit (SCM) dhe - nëse është leje e Tipit A – qasja duhet të jetë e bazuar në teknikat më të mira në dispozicion.

VKSh-të për instalime të mëdha industriale duhet të bazohen në një vlerësim të kombinuar të objektivave të cilësisë së mjedisit dhe gjendjes aktuale të teknologjisë për të reduktuar çlirimet e dëmshme. Për të përdorur qasjen e kombinuar, autoriteti i lejeve duhet të kalojë nëpër hapat e mëposhtëm:

- Të vlerësoj se çfarë Tip leje është instalimi A, B apo C.
- Të vlerësoi efektin kumulativ të mundshëm, nga instalimet e tjera.
- Të konsideroi VKSh-të e zbatueshme siç përcaktohen në legjislacionin, dhe nëse është kështu, VKSh-të në leje duhet të jenë, minimalisht, në përputhje me ato të përcaktuara në ligj.
- Për Lejen e Tipit A – duhet të vendosen Vlerat Kufi të Shkarkimeve, bazuar në teknikën më të mirë në dispozicion (mund të jenë më të rrepta se sa standardet kombëtare).
- Nëse një SCM nuk mund të arrihet edhe me përdorimin e TMD, në një instalim të veçantë, rregullatori duhet ose të marrë masa për të reduktuar shkarkimet nga impiantet e tjera në zonë (duke siguruar përputhjen me SCM) ose të refuzoj lejen në fjalë.